



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 19 (827823)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 12 maj 2023

“Arsimimi Ushtarak Shqiptar - 65 vjet Akademi e Forcave të Armatosura”

Arsimimi Ushtarak Shqiptar - 65 vjet Akademi e Forcave të Armatosura”, mbledhi në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes studiues të historisë ushtarake, kërkues shkencorë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, në fushën e arsimit dhe doktrinës. Krijimi i Akademisë Ushtarake është një ngjarje e rëndësishme e historisë së arsimit ushtarak, të kulturës dhe shkencës ushtarake në nivel kombëtar. Akademia e

Forcave të Armatosura në rrugëtimin e saj 65-vjeçar ka kontribuar në përgatitjen e shumë brezave të lidërshipt ushtarak, në zhvillimin dhe konsolidimin e Forcave të Armatosura. Për të sjellë edhe njëherë në vëmendje rolin dhe vlerën e këtij institucioni arsimor, Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri do të shprehë: “10 Maji është një nga ditët më të rëndësishme në historinë e arsimit

ushtarak shqiptar, është dita krijimit të Akademisë së Forcave të Armatosura, dhe sot mbushen 65 vjet nga krijimi i saj. Përcjell urimet më të përzemërta për të gjithë studentët dhe kursantët, personelin akademik dhe jo akademik, ushtarak dhe civil, që sot janë pjesë e Akademisë së Forcave të Armatosura. Puna dhe kontributi juaj i vyer e i përditshëm, gjithnjë e më shumë po i shërben rritjes... >> faqe 4



SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në Takimin e 189-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s



>> faqe 3

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Major Klodian TANUSHI dhe nëntetare Zarife HASANAJ, histori lavdie e Forcave të Armatosura

Me rastin e 5 Majit “Ditës së Dëshmorëve të Atdheut”, në Batalionin e Xhenios u organizua një ceremoni përkujtimore për ushtarakët shqiptarë rënë në krye të detyrës. Për të respektuar këtë ditë të rëndësishme për historinë e popullit shqiptar, mori pjesë dhe zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e cila në fjalën e saj do të shprehë: “Sot është një ditë e shënuar, 5 Maji ‘Dita e Dëshmorëve’, një datë e rëndësishme historike për shqiptarët, pasi përkujtohen Dëshmorët e Atdheut. Në këtë ditë të...



>> Faqe 2

Forca Tokësore zhvilloi stërvitjen “Përkujdesja ndaj Viktimave të Luftës Taktike”

Ekipi këshillues i manovrës nga batalioni I i Brigadës së Asistencës së Forcave të Sigurisë (SFAB) së SHBA-së, i vendosur pranë batalionit të dytë të këmbësorisë në Forcën Tokësore, zhvilloi stërvitjen mbi “Përkujdesjen ndaj Viktimave të Luftës Taktike” me efektivë të kësaj njësie. Njëherazi, këshilltarë të batalionit të 6-të të SFAB iu bashkuan stafit të Brigadës Shumëkombëshe të Task Forcës së Jugut (e dislokuar në Zall Herr), në kuadër të përgatitjeve mbi stërvitjen...



>> Faqe 5

Kontributi i personaliteteve ushtarake të AFA-së ndër vite

Veprimtaria drejtuese dhe pedagogjike në periudhën e Luftës së Ftohtë, nga 1958-1992 ishte e lidhur me Akademinë, kur punohej intensivisht për ta vënë mbi themele të shëndosha, për ta bërë të aftë të ecte me hapin e kohës, dhe për ta shndërruar në një nyje me ndikim të fuqishëm në zhvillimin e FA. Mirëpo Akademia ka edhe parahistorinë e saj, pra ndodhitë e asaj periudhe që e bënë të mundur e të domosdoshëm aktin e themelimit më 1958. Me këtë periudhë, të themi përgatitore, është e pleksur një copëz...



>> Faqe 6

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Major Klodian TANUSHI dhe nëntetare Zarife HASANAJ, histori lavdie e Forcave të Armatosura

Me rastin e 5 Majit “Ditës së Dëshmorëve të Atdheut”, në Batalionin e Xhenios u organizua një ceremoni përkujtimore për ushtarakët shqiptarë rënë në krye të detyrës.

Për të respektuar këtë ditë të rëndësishme për historinë e popullit shqiptar, mori pjesë dhe zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e cila në fjalën e saj do të shprehej:

“Sot është një ditë e shënuar, 5 Maji ‘Dita e Dëshmorëve’, një datë e rëndësishme historike për shqiptarët, pasi përkujtohen Dëshmorët e Atdheut. Në këtë ditë të shënuar kudo në vendin tonë, kujtohen me nderim e respekt dëshmorët, ata që dhanë jetën për Shqipërinë, ata që flijuan jetën e tyre për çlirim kombëtar, për liri e demokraci. Sot, të gjithë njerëzit u drejtohen varrezave të dëshmorëve dhe simboleve të ngritura në nderim të tyre për të vendosur buqeta me lule të freskëta.

Edhe ushtarakët në këtë ditë të shënuar kujtojnë dëshmorët e vet, që nuk janë të paktë, duke filluar nga pilotët e Forcës Ajrore, të Forcave Komando e Speciale, të studentëve e pedagogëve të shkollës së bashkuar, rënë në malin e Fekenit, etj. Të gjithë krenohemi me sakrificat e tyre sublime dhe përulemi me respekt e mirënjohje ndaj veprës së tyre.

Më tej gjeneralmajor Shehu, e cila mes familjarëve të dy dëshmorëve, Major Klodian TANUSHIN dhe Nëntetare Zarife HASANAJ theksoi se: “Sot ne ndodhemi në këtë repart për të kujtuar dy dëshmorët e këtij reparti elitë të Forcave të Armatosura, i cili prej vitësh jep kontribut të jashtëzakonshëm në emergjencat civile në vend, duke shpëtuar jetë njerëzish, por edhe duke kontribuar në dobi të paqes e sigurisë në rajon e më gjerë, siç është rasti i pjesëmarrjes së personelit të tuaj prej disa vitësh në misionin në Letoni.

Jemi këtu sot për të kujtuar dy ushtarakët e repartit tuaj, dy dëshmorët e atdheut që dhanë jetën në krye të detyrës në misionin paqeruajtës



në Letoni, pikërisht Major Klodian TANUSHIN dhe Nëntetare Zarife HASANAJ. Ata flijuan jetën në lulen e rinisë, duke lënë në pikëllim familjet e të afërmit e tyre, por edhe të gjithë ne, pjesëtarët e Forcave të Armatosura.

Në këtë ditë të shënuar ju sjell edhe

përsëritjet të veçantë të Ministrisë të Mbrojtjes, zotit Niko Peleshi dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji. Vlerësim e mirënjohje aktit të tyre sublim!

Rënia e tyre në krye të detyrës,

është dëshmi e gjallë e përkushtimit dhe sakrificës të Forcave tona të Armatosura, në çdo angazhim dhe mision të NATO-s, në shërbim të qytetarëve dhe sigurisë së vendit dhe asaj globale.

Po bëhen gati katër vjet që Klodianin e Zarifin nuk i kemi midis nesh, vetëm fizikisht, pasi me aktin e tyre sublim, i kemi në çdo kohë si frymëzim në kryerjen e detyrave, aq më shumë personeli që vijon kryerjen e misionit në Letoni. Emri i tyre nderohet në Aleancë, rënia e tyre përkujtohet sot nga kolegët e NATO-s. Por emri i Klodian Tanushit rron sot në shkollën e re 9-vjeçare të Qesarakut të Tiranës, ashtu si emri i Zarife Hasanaj në kopshtin e Babrusë në Tiranë.

Ata sot nuk gjenden më fizikisht midis nesh, por mbeten pjesë e jona, e historisë dhe lavdisë së Forcave të Armatosura; simbol i përgjegjësisë, gatishmërisë dhe përkushtimit për kryerjen e misionit dhe detyrës fisnike të ushtarakut në emër të atdheut.

Sakrificat sublime e tyre nuk do të harrohet. Ajo është pjesë e motivimit të përditshëm të të gjithë vajzave, grave dhe burrave në uniformë, të cilët të heshtur dhe pa zhurmë, janë çdo ditë, brenda dhe jashtë vendit, të gatshëm dhe në shërbim të nevojave dhe detyrimeve kombëtare dhe euroatlantike.

Sot, në këtë ditë të veçantë i bashkohemi dhimbjes së familjeve TANUSHI e HASANAJ për të kujtuar me nderim dhe respekt veprën dhe ndarjen nga jeta të këtyre bijve të pazëvendësueshëm, të ushtarëve, heronjve dhe dëshmorëve të Shqipërisë.

Ju, familjarë të nderuar, asnjëherë nuk do jeni vetëm. Ne do të jemi gjithmonë me ju, Forcat e Armatosura do të jenë me ju, ne do të jemi gjithmonë bashkë. Ata do rrojnë në jetë në zemrat e familjarëve dhe të Forcave të Armatosura.

I paharruar qoftë kujtimi i Dëshmorëve të Atdheut!

I paharruar kujtimi i dëshmorëve Klodian TANUSHI dhe Zarife HASANAJ!

Ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri, z. Peter Zingraf ishte i pranishëm në Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-13), ku referoi temën “Procesi i integritimit në Bashkimin European”. Diplomati u prit më pas në një takim informues nga drejtuesit e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.





SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në Takimin e 189-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, mori pjesë në Takimin e 189-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s, në Bruksel, Belgjikë.

Shefat e Mbrojtjes u mbledhën në këtë takim për të diskutuar mbi sfidat dhe prioritetet kryesore të Aleancës përpara Samitit të Vilniusit. Gjatë këtij takimi ata vlerësuan progresin në zhvillimin e Planeve Rajonale dhe Modelin e ri të Forcave të NATO-s, i nevojshëm për të pasur më shumë trupa në gatishmëri të lartë, në përgjigje ndaj çdo situatë dhe nevojë.

Shefat e Mbrojtjes diskutuan gjithashtu edhe rreth zhvillimit të Planeve Rajonale të Mbrojtjes, kërkesat për forca ushtarake për strukturën e Aleancës si dhe rishikimin e komandim - kontrollit.

Ky takim i rëndësishëm i paraprin zhvillimit të Samitit të Vilniusit, që do të mbahet në muajin korrik, ku mbështetja politike duhet të shkojë paralelisht me objektivat strategjike ushtarake, në epokën e re të mbrojtjes kolektive dhe vlerave demokratike që po cenohen për mbi 15 muaj, që pas agresionit rus në Ukrainë.



Shefat e Mbrojtjes diskutuan gjithashtu edhe rreth zhvillimit të Planeve Rajonale të Mbrojtjes, kërkesat për forca ushtarake për strukturën e Aleancës si dhe rishikimin e komandim - kontrollit.

Helikopteri 'Cougar' vazhdon misionin...

Ekvipazhi i helikopterit 'Cougar' pasditen e djeshme, ka bërë të mundur shpëtimin e tre alpinistëve çek që kishin mbetur të bllokuar në Malin e Jezercës. Mbas marrjes së njoftimit, strukturat e bazës ajrore Farkë vendosën në dispozicion helikopterin për kërkimin dhe gjetjen e vendndodhjes së turistëve që kishin kërkuar ndihmë. Koha e reagimit ka qenë tepër e shpejtë, që nga marrja e sinjalit dhe deri në lokalizimin dhe transportimin e turistëve të bllokuar në lartësitë e Jezercës. Gjendja shëndetësore e tyre ishte shumë e mirë.

Forca Ajrore, me kapacitetet që disponon, ngelet e gatshme për t'iu përgjigjur në çdo kohë dhe në çdo vend kërkesave në mbështetje të autoriteteve civile.





“Arsimimi Ushtarak Shqiptar - 65 vjet Akademi e Forcave të Armatosura”

“Arsimimi Ushtarak Shqiptar - 65 vjet Akademi e Forcave të Armatosura”, mbledhi në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes studiuues të historisë ushtarake, kërkues shkencorë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, në fushën e arsimit dhe doktrinës.

Krijimi i Akademisë Ushtarake është një ngjarje e rëndësishme e historisë së arsimit ushtarak, të kulturës dhe shkencës ushtarake në nivel kombëtar.

Akademia e Forcave të Armatosura në rrugëtimin e saj 65-vjeçar ka kontribuar në përgatitjen e shumë brezave të lidërshipt ushtarak, në zhvillimin dhe konsolidimin e Forcave të Armatosura.

Për të sjellë edhe njëherë në vëmendje rolin dhe vlerën e këtij institucioni arsimor, Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri do të shprehë: “10 Maji është një nga ditët më të rëndësishme në historinë e arsimit ushtarak shqiptar, është dita krijimit të Akademisë së Forcave të Armatosura, dhe sot mbushen 65 vjet nga krijimi i saj.

Përcjell urimet më të përzemërta për të gjithë studentët dhe kursantët, personelin akademik dhe jo akademik, ushtarak dhe civil, që sot janë pjesë e Akademisë së Forcave të Armatosura.

Puna dhe kontributi juaj i vyer e i përditshëm, gjithnjë e më shumë po i shërben rritjes dhe konsolidimit të Akademisë dhe shndërrimit të saj në “vatrën” e krijimit të gjeneratës së re të oficerëve të Forcave të Armatosura, por edhe kontribuues në zhvillimin e shoqërisë, duke formuar liderin e ardhshëm e me karakter të përkushtuar ndaj vlerave që burojnë nga tre fjalët e shenjta Nderi – Detyra – Atdheu, të cilat diktojnë se çfarë duhet të jemi, çfarë mund të jemi dhe çfarë do të jemi.

Historia 65-vjeçare e Akademisë ka thesar të saj ka kontributin, përkushtimin, profesionalizmin, devocionin dhe përpjekjet e palodhura të gjithë atyre që kanë qenë pjesë e saj në këtë udhëtim. Thellësisht mirënjohës e falënderues për gjithçka ato mundën dhe bënë për arsimimin ushtarak dhe Akademinë e Forcave të Armatosura.

Në këtë përvjetor të shënuar të 65-vjetorit të AFA-së, një falënderim



i veçantë shkon për të gjithë ata që pavarësisht se nuk janë drejtpërdrejt pjesë e Akademisë së Forcave të Armatosura, me mbështetjen e tyre kanë qenë janë e do të jenë pjesë e

rëndësishme e suksesit dhe arritjeve të Akademisë.

Ndërsa zëvendëseshfi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Manushaq Shehu, në fjalën e saj të

rastit do të sillte këndvështrimin historik të zhvillimit të Akademisë të Forcave të Armatosura: “Konferenca të tilla janë të rëndësishme, sepse ato synojnë të vendosin piketat se ku duhet të shkojë arsimit, trajnimi dhe stërvitja në FA. Zhvillimi edhe në kuadër të 65-vjetorit të AFA-së është edhe më domethënës dhe kuptimplotë.

Kjo është e kuptueshme, sepse akademia ka qenë simboli, dinjiteti, trashëgimtarja dhe bashkudhëtarja e të gjitha ndryshimeve, zhvillimeve dhe përparimeve të arsimit tonë ushtarak. Është rasti të shpreh mirënjohjen për kontributin dhe vlerat e të gjithë brezave të pedagogëve, instruktorëve, drejtuesve e kërkuesve, që kanë punuar dhe shërbyer në këtë institucion të arsimit të lartë.

Aktualisht ne jemi në proces të zbatimit të një pakete ndryshimesh dhe

zhvillimesh në të gjithë FA-në. Një nga prioritetet e këtyre zhvillimeve është edhe sistemi arsimor. Fakti është që jemi në kërkim dhe zhvillim të një sistemi arsimimi ushtarak të standardeve bashkëkohore, të qëndrueshëm dhe cilësor. Për këtë qëllim, tashmë ne kemi përcaktuar si objektiv modelin elitare të ‘West Point-it’.

Sistemi ynë i sotëm arsimor, është guri i themelit të suksesit apo dështimit tonë në të ardhmen.

Ne jemi të vetëdijshëm për problemet e sotme të arsimit ushtarak.

Kjo do të thotë që një nga pritjet e konferencës duhet të jetë përmirësimi i gjendjes së sistemit tonë arsimor ushtarak, i cilësisë, profesionalizmit, fleksibilitetit dhe deri tek kohezioni i tij edhe me standardet dhe politikatat arsimore të vendeve të Aleancës.

Prandaj, ndër sfidat kryesore aktuale, që unë shikoj dhe besoj t’i konsideroj edhe kjo Konferencë, janë zhvillimi dhe konsolidimi i shpejtë i shkollës tonë të përgatitjes së oficerit të ri dhe orientimi i studiuar e i saktë i arsimit tonë ushtarak në tërësi, në të gjitha nivelet dhe për të gjitha kategoritë, drejt nevojave reale të FA-së. Neve na duhet një sistem fleksibël dhe adaptiv ndaj një mjedisi që ndryshon vazhdimisht dhe me shpejtësi. Synimi final i arsimit tonë është përgatitja e ushtarakëve tanë të aftë për t’u përballur me një mjedis të tillë”, - do të mbyllte fjalën e saj gjeneralmajor Shehu.

Në fjalën e tij përshëndetëse zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Joti falënderoi studiuesit, kërkuesit shkencorë si dhe profesorët e AFA-së për impenjimin në vite drejt perfeksionimit të arsimit të Forcave të Armatosura si dhe ofroi mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes për trajnimin dhe urat e bashkëpunimit me simotrat tona në NATO. Më tej konferenca vazhdoi me të tjerë referate, të cilët trajtuan tematika të ndryshme rreth ecurisë së këtij institucioni dhe pikësynimet e së ardhmes së afërt.

Në fund të konferencës në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm u shpërndanë certifikata mirënjohjeje për kontribuuesit në fushën e arsimit, mbrojtjes dhe sigurisë.



Forca Tokësore zhvilloi stërvitjen "Përkujdesja ndaj Viktimave të Luftës Taktike"

Ekipi këshillues i manovrës nga batalioni I i Brigadës së Asistencës së Forcave të Sigurisë (SFAB) së SHBA-së, i vendosur pranë batalionit të dytë të këmbësorisë në Forcën Tokësore, zhvilloi stërvitjen mbi "Përkujdesjen ndaj Viktimave të Luftës Taktike" me efektivë të kësaj njësie.

Njëherazi, këshilltarë të batalionit të 6-të të SFAB iu bashkuan stafit të Brigadës Shumëkombëshe të Task Forcës së Jugut (e dislokuar në Zall Herr), në kuadër të përgatitjeve mbi stërvitjen ndërkombëtare "Immediate Response", pjesë e paketës së "Defender Europe-23", udhëhequr nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Europën dhe Afrikën, që do të zhvillohet në periudhën Maj - Qershor 2023.



Nën drejtimin e instruktorëve të saj më të mirë, prej disa ditësh në repartin ushtarak nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër dhe repartin ushtarak nr. 1030 Poshnje, Berat, ka filluar Stërvitja Individuale Bazë (SIB) dhe Stërvitja Individuale e Avancuar (SIA). Synimi i këtyre kurseve është transformimi i rekrutëve të rinj nga civilë, në qytetarë të denjë nën uniformë, për t'i shërbyer atdheut në çdo kohë dhe në çdo vend.



Toga MADM e batalionit të mbështetjes me luftim, e Forcës Tokësore, pjesëmarrëse në stërvitjen shumëkombëshe "Combine Resolve", e cila zhvillohet nga Komanda VII e trajnimit të Ushtrisë Amerikane për Europën dhe Afrikën (USEURAF) në Hohefels, Gjermani, vijon me sukses detyrat e organizimit të patrullave të zbulimit kimik dhe radiacionit, kontrollin e zonës së operacionit, ngritjen e postave të zbulimit kimik dhe radiacionit, si dhe mbajtjen në gatishmëri të sistemit të dekontaminimit masiv.



Kontributi i personaliteteve ushtarake të AFA-së ndër vite



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Nderim dhe mirënjohje për figura të shquara

Veprimtaria drejtuese dhe pedagogjike në periudhën e Luftës së Ftohtë, nga 1958-1992 ishte e lidhur me Akademienë, kur punohej intensivisht për ta vënë mbi themele të shëndosha, për ta bërë të aftë të ecte me hapin e kohës, dhe për ta shndërruar në një njeje me ndikim të fuqishëm në zhvillimin e FA. Mirëpo Akademia ka edhe parahistorinë e saj, pra ndodhitë e asaj periudhe që e bënë të mundur e të domosdoshëm aktin e themelimit më 1958. Me këtë periudhë, të themi përgatitore, është e pleksur një copëz e jetës së drejtuesve dhe pedagogëve, në të cilën kontributi i tyre ka qenë i vyer e me peshë. Janë vërtet çaste të rëndësishme të rrugës së përparimit arsimor ushtarak, ndriçimi i të cilave në sfondin e kuadrit dhe perspektivës historike, kërkon vëmendjen e studiuesve dhe të akademistëve.

Prandaj krenimi i 65-vjetorit të krijimit të Akademisë në jep rastin të përkujtojmë me respektin, nderimin dhe mirënjohjen për figura të shquara që vunë njohuritë, talentin dhe, mbi të gjitha, punën plot pasion, në shërbim të misionit fisnik për të cilin u ngrit ky institucion. Ata i dhanë këtij institucioni emër të mirë e prestigj për ta përligjur cilësimin “tempull i dijes ushtarake”, si institucioni më i lartë akademik e shkencor ushtarak në vend për përgatitjen e pajisjes e kuadrit ushtarak të rangut të mesëm e të lartë, me dije e praktika bashkëkohore për luftën e kohëve modern, duke i hapur gjithnjë e më shumë rrugë mendimit bashkëkohor ushtarak e për t’u renditur kështu me dinjitetin e duhur krahas institucioneve të tjera të ngjashme.

Institucioni i përshkoi vitet që nga krijimi e gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë, duke reflektuar hap pas hapi çdo ndryshim të rëndësishëm që ndodhte në vend si në pamjen e mendimit ushtarak shqiptar ashtu edhe të organizimit, përhapjes dhe përgatitjes së FA-së dhe të komandave e shtabeve të shkallës taktike e operative sipas konceptit themelor të kohës, të “popullit-ushtar”, sikurse thuhej, për realizimin e kauzës së shenjtë të mbrojtjes së At-dheut. Statusi i Akademisë kërkonte që procesi mësimor e akademik të ecnin në një hap me ndryshimet që kushtëzonte politika e partisë-shtet për përgatitjen e mbrojtjen e atdheut ndaj çdo agresioni të mundshëm ushtarak në një a disa drejtime strategjike njëherësh.

Në ecurinë e trupës pedagogjike dhe drejtuese të Akademisë në vitet 1958-1992, pra Lufta e Ftohtë, vërehen disa dukuri që mund t’i klasifikojmë në dy periudha. E para, nga krijimi deri në vitin 1974 dhe e dyta nga vitin 1975 deri në vitin 1992. Këto periudha në mënyrë të përmblodhur e të gërshetuar përfaqësojnë periudhat e Luftës së



Ftohtë në kuptimin e sistemit politik në Shqipëri, të konceptit të strategjisë, artit operativ e të taktikës ushtarake dhe të programeve e metodave mësimore. Të dyja etapat e kohështirjes së Luftës së Ftohtë, misioni kryesor i Akademisë Ushtarake ishte aftësimi e përgatitja e gjithë kuadrit drejtues e komandues në shkallë batalion-brigadë e më pas në fazën e dytë edhe korpus e divizion. Pas Luftës së Ftohtë, vjen periudha e demokracisë (1992-2023), kohë në të cilat shtrihet veprimtaria 65-vjeçare e institucionit të Akademisë.

Në këtë këndvështrim, trupa pedagogjike e drejtuese në periudhën e parë karakterizohet nga oficerë madhorë të përgatitur kryesisht në Akademitë Ushtarake të Bashkimit Sovjetik. Ata paraqiteshin cilësorë në formimin e tyre profesional dhe bartnin e reflektonin natyrshëm filozofinë e metodologjinë e arsimit ushtarak të Bllokut Lindor, e cila qëndronte edhe në themel të sistemit politik të kohës në Shqipëri. Ndërsa në periudhën e dytë, trupa pedagogjike e drejtuese e Akademisë përbëhej sërish nga oficerë madhorë e nga më cilësorët e kohës, por me ndryshimin e natyrshëm të brezit. Thënë ndryshe, ky brez drejtuesish e pedagogësh ishte për herë të parë produkt i vetë institucionit të Akademisë, nxënës e vazhdues të brezit të periudhës së parë. Ndryshimi kryesor që vërehet midis këtyre dy brezave, qëndronte në faktin se brezit të dytë iu desh të reflektonte natyrshëm ashpërsimin e sistemit autoritar politik në vend dhe thellimin e izolimit politik, ushtarak, ekonomik e kulturor që shoqëroi vitet ‘80 në Shqipëri. Sikundër e ka vënë në dukje nobelisti Indian, ekonomisti Amartya Sen “Muri i Berlinit nuk ishte vetëm një simbol i mbajtjes së popullit brenda Gjermanisë; ai ishte më tepër një mënyrë për të penguar

vështrimin global të së ardhmes”.

Gjithsesi, Akademia përgatiti e kualifikoi në kurset e niveleve të ndryshme një numër të madh oficerësh e drejtuesish ushtarakë, ku ende vazhdojnë të shërbejnë e drejtojnë me përkushtim dhe sot në Forcat e Armatosura apo fusha të tjera të spektrit shoqëror shqiptar. Rruga jetësore e çdo njeriu kushtëzohet nga rrethanat e përgjithshme të kohës, por edhe nga mjedisi i veçantë familjar në të cilin ai formohet dhe edukohet sipas një kodi të caktuar aksiologjik, pra një hierarkie vlerash që duhen respektuar. Natyrisht, këto janë mjaft përcaktuese, por në një masë jo të vogël, njeriu është arkitekt i jetës së vet.

Elita intelektuale të ushtrisë

Ngritja e Akademisë qe një akt i guximshëm. Në qoftë se Akademia e fitoi relativisht shpejt fizionominë e vet dhe e kreu me dinjitet shkencor misionin që i ishte besuar, kjo ndodhi se në të u angazhuan persona që i takonin elitës intelektuale të ushtrisë në atë periudhë.

Ndaj dhe personalitete ushtarake si Thoma Xhixho, Spiro Shalësi, Ernest Jakova, Koli Mborja, Vaskë Gjino, Mendu Tetova, Vehbi Hoxha, Kostaq Karoli, Halim Abazi etj., na ngjajnë me nuancat e pafundme të natyrës, të cilën sa herë e vështron të shfaqet me shkëlqime, që nuk i ke vënë re më parë.

Sa herë i jemi kthyer shkrimeve të Spiro Shalësit, gjithnjë kemi zbuluar në personalitetin e tij diçka të re, që nuk e kemi dalluar dhe nuk e kemi njohur më parë. Kushdo që pati lidhje të afërta me Ernest Jakovën, ka vënë re në personalitetin e tij, katër tipare themelore: një butësi gati mbinjerëzore të karakterit, që i detyronte të tjerët instiktivisht ta adhuronin, një pasion të madh, thujse të lindur, për arsimin ushtarak, një vizion dhe një besim të madh për të ardhmen e atdheut, një qëndrim krijues e frymë kërkimore për çdo punë të madhe apo të vogël.

Thoma Xhixho akademienë e quante derë të hapur të zhvillimit të shkencës ushtarake shqiptare. Ai kishte për detyrë që ta ngrinte këtë institucion edhe në qendër kërkimore, prandaj theksonte se çelja e institucioneve ushtarake përbën një ngjarje të rëndësishme për njerëzit e shkencës dhe të arsimit në ushtri, se ata do të gjejnë një mbështetje të madhe për punën e tyre shkencore.

Vehbi Hoxha në shkrimet e tij theksonte se historia e popullit tonë ka ende fusha të pazbuluara dhe të pavëna në dritë, konkretisht për fushën e historisë ushtarake, që kanë nevojë të gërmohen për të nxjerrë në shesh të kaluarën tonë si popull e si komb. Profesorë e studentë, duke zhvilluar programet mësimore, njëkohësisht do të bëjnë studime mbi tema të veçanta për të qenë të lidhur me përparimet e shkencës ushtarake.

Vaskë Gjino, rëndësi iu kushtonte metodave të të dhënit mësim, aftësisë së pedagogut të akademisë për të paraqitur qartë në përputhje me programin atë që është dhe atë që është e dorës së dytë, për t’i dhënë mundësi mendjes së akademistit që, pasi të përvetësojë nocionet themelore, të ecë vetë në mënyrë të pavarur në njohjen e gjërave, në pasurimin e mendimit ushtarak.

Mendimi pedagogjik ushtarak, Koli Mborja theksonte se kryevendin e zë pedagogu, misioni, pozita, kultura dhe kualifikimi i tij. Ky problem ndjehet si lajtmotiv në të gjithë trashëgiminë e tij të shkruar.

Ndërsa Mendu Tetova theksonte se nuk ka rrugë më të shkëlqyer se sa ajo që çahet me mend, me sakrificë e që në ballë të saj qëndron një mision aq i lartë si ai i oficerit, i përgatitjes për mbrojtjen e At-dheut, por dhe si një përhapës i dijes dhe kulturës ushtarake.

Të gjithë së bashku dhe veç e veç luftuan për të rrënjësuar konceptin për misionin e pedagogut të Akademisë, i cili duhet të mbetet nxënës gjithë jetën,

të zgjerojë kulturën me përpjekje individuale, duke u shkundur nga përtësia intelektuale, pasi sa më i lartë të jetë niveli shkencor i pedagogut, aq më të larta do të jenë rezultatet e punës mësimore-edukative dhe shkencore në ushtri.

Deri në vitin 1974, të gjitha materialet teorike dhe praktike të drejtuesve dhe pedagogëve të Akademisë, pasqyroheshin në rregullore dhe në buletine ushtarake, por në emër të MM dhe të Shtabit të përgjithshëm. Veçse në Revistën Ushtarako-Politike bëheshin trajtesa me emër nga kuadro dhe pedagogë të cilët janë të shumtë në faqet e saj. Kjo ishte një revistë ushtarake dhe politike që trajtonte teori, koncepte, dukuri nga fusha e artit ushtarak shqiptar dhe botëror dhe dilte një herë në muaj.

Nga akademia janë vlerësuar në këtë periudhë me tituj profesor Mendu Backa dhe Spiro Adhami, si dhe titullin shkencor Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor Abedin Galanxhi, Alfred Moisu, Arja Qirjako dhe Gaqo Pojani. Çmim të Republikës ka marrë Shahin Leka.

Të gjithë drejtuesit dhe njëkohësisht edhe pedagogët i kushtuan shumë rëndësi inkurajimit dhe stimulimit moral të pedagogëve si në festimet publike të ditëlindjeve, të jubileve të punës së tyre në arsim, duke i thirrur në organet më të larta të pushtetit për t’i falënderuar për punën e tyre të palodhur dhe duke u akorduar medalje e tituj të lartë.

Njohje të trashëgimisë dhe të traditës

Përkushtim ndaj parimeve të rëndësishme të lirisë akademike me qëllim që institucioni i Akademisë të inkurajojë fort krijimin, novacionin, eksperimentimin, rritjen intelektuale dhe jo konformizmin në klasë dhe në administrim.

Përfaqse ndaj të shkruarit profesional, njohje të personaliteteve ushtarake shqiptare, duke ndjekur parimin se “mosrënia dakord nuk është mungesë respekti”. Institucioni i Akademisë të vendosë theks të veçantë në punën kërkimore dhe me shkrim, si dy tipare të rëndësishme të arsimit të lartë civil e ushtarak.

Drejtuesi i ardhshëm ushtarak apo civil duhet të mundet të mendojë jo vetëm në mënyrë realiste, por dhe në mënyrë kritike e origjinale, me imagjinatë e kërshëri të ushqyer nga periudha e gjatë e leximit, kërkimit e shkrimit, për të shtjelluar ide jashtë kornizave të njohura në klasë.

Njohja e trashëgimisë dhe traditës së kaluar ushtarake të institucionit, nëpërmjet studimeve, botimeve dhe trajtesave teorike duhet të jetë një risi e re për të kuptuar bazat në të cilat u hodhën themelet dhe u ngrit godina teorike e Akademisë. Zhvillimi i mendimit të pavarur, i cili nuk është gjithnjë i mirëpritur, nga vetë natyra e profesionit ushtarak për të arritur në mendimin e kundërshtarit dhe për të vepruar në situata jo të qarta kërkon nga institucioni të zhvillojnë tek studentët mendimin kritik dhe aftësinë e reflektimit.

SESIONI I 189-TË I KOMITETIT USHTARAK TË SHEFAVE TË MBROJTJES

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

NATO përgatitet për një epokë të re të mbrojtjes kolektive

Autoriteti më i lartë Ushtarak i NATO-s, Komiteti Ushtarak, u takua në selinë e NATO-s në Bruksel, më 10 maj 2023, në Sesionin e 189-të të Komitetit Ushtarak të Shefave të Mbrojtjes. Takimi mbledhi së bashku shefat e mbrojtjes aleate dhe homologun e tyre të fuar nga Suedia dhe u mbështet nga gjeneral Christopher Cavoli, Komandanti Suprem i Aleatëve për Evropë (SACEUR) dhe gjeneral Philippe Lavigne, Komandanti Suprem i Aleatëve për Transformimin (SACT). Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg iu bashkua seancës së parë të takimit për të trajtuar prioritetet dhe sfidat kryesore të Aleancës përpara Samitit të Vilniusit.

Në fjalën e tij të hapjes, admirali Rob Bauer, Kryetar i Komitetit Ushtarak, përgëzoi Sekretarin e Përgjithshëm për "udhëheqjen e tij të pashembullt" gjatë kohërave sfiduese për sigurinë globale. Për luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, admirali Bauer tha se Rusia tani është në muajin e pesëmbëdhjetë, ndërkohë që ajo shpresonte se do të ishte një luftë 3-ditore. "Goliath po lëkundet dhe kjo është për shkak se Davidi ka treguar një elasticitet të jashtëzakonshëm dhe shkëlqim taktik, të mbështetur nga 50 vende në mbarë botën", - tha ai. (Frazja "David dhe Goliath" ka marrë një kuptim më popullor që tregon një situatë të dobët, një garë ku një kundërshtar më i vogël, më i dobët përballat me një kundërshtar shumë më të madh dhe më të fortë).

Sekretari i Përgjithshëm falënderoi udhëheqësit ushtarakë të NATO-s për punën e tyre në transformimin e Aleancës gjatë dekadës së fundit dhe për të siguruar që ajo të jetë e përgatitur mirë për një "epokë të re të mbrojtjes kolektive". Pas pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia, në shkurt 2022, NATO aktivizoi të gjitha planet e saj të mbrojtjes, vuri 40 000 trupa nën komandën e NATO-s, të mbështetur nga fuqi të konsiderueshme ajrore dhe detare dhe forcoi mbrojtjen e saj përpara. "Këto veprime zvogëlojnë rrezikun e llogaritjes së gabuar dhe përshkallëzimit. Duke e bërë të qartë si kristali, ne do të mbrojmë çdo centimetër të territorit të NATO-s", - tha Stoltenberg.

Autoritetet Ushtarake të NATO-s po zhvillojnë Plane Rajonale. Këto janë plane gjeografikisht specifike, që përshkruajnë se si Aleanca do të mbrohet kundër dy kërcënimeve të përshkruara në Konceptin Strategjik të NATO-s dhe në Strategjinë Ushtarake të NATO-s, Rusia dhe grupet terroriste. Planet Rajonale kërkojnë një model të ri të forcave të NATO-s për të prodhuar më shumë trupa me gatishmëri të lartë në të gjithë Aleancën, si dhe një Strukturë të Re Forcash për të përcaktuar numrin dhe llojet e pajisjeve dhe organizatave të nevojshme për të kryer operacionet e NATO-s.

Admirali Bauer vlerësoi përpjekjet herkuliane të kryera nga SHAPE dhe Komandat e Forcave të Përbashkëta Brunssum, Napoli dhe Norfolk për të integruar NATO-n dhe planifikimin ushtarak kombëtar në një nivel kaq të detajuar. Admirali Bauer tha se "Kjo bën të mundur mbrojtjen kolektive jo vetëm të sigurisë fizike të një miliardë njerëzve tanë dhe 31 kombeve, por edhe vlerat demokratike që ne të gjithë i mbajmë të shtrenjta".

Sekretari i Përgjithshëm përshkroi disa nga prioritetet kryesore për Samitin e Vilniusit në korrik për të forcuar më tej parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s. Këto përfshijnë mbështetjen e planeve të reja rajonale të mbrojtjes, së bashku me një premtime ambicioz për investime të



reja në mbrojtje dhe një plan të ri veprimi për prodhimin e mbrojtjes. "Ne kemi nevojë për atë kapacitet investimi dhe prodhimi tani dhe afatgjatë. Ne po ecim në drejtimin e duhur, por jo aq shpejt sa kërkon bota e rrezikshme në të cilën jetojmë", - tha Stoltenberg.

Për herë të parë në takim ishte pjesëmarrës gjenerali finlandez Timo Kivinen pas antarësimit të Finlandës në NATO. Për herë të parë, ishte gjithashtu shefi i Mbrojtjes të Gjermanisë, gjenerali Carsten Breuer, gjenerali José Nunes da Fonseca nga Portugalia si dhe gjeneralletenant Gábor Böröndi nga Hungaria, të cilët kanë detyrën e shefit të Mbrojtjes në vendin e tyre. Në takim merrte pjesë edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së shqiptare gjeneral brigade Arben Kingji.

NATO diskuton zhvillimin e planeve rajonale

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admirali Rob Bauer, në fjalën e tij në hapje të seancës së parë të sesionit të 189-të të Komitetit Ushtarak të Shefave të Mbrojtjes e vlerësoi praninë e Sekretarit të Përgjithshëm në këtë takim. "Është një dëshmi e natyrës unike të Aleancës sonë politiko-ushtarake. Në këtë seli, në baza ditore, niveli politik dhe ushtarak gjejnë konsensus se si të mbahen më së miri 1 miliard njerëz të sigurt. Së bashku, ne sigurohemi që vullneti politik të përputhet me aftësitë ushtarake. Roli i këtij Komiteti është vendimtar, këshillat tona të papenguara për nivelin politik të NATO-s ndihmojnë për të siguruar që ajo që është politikisht e dëshirueshme dhe e realizueshme ushtarakisht", - tha ai. Admirali Bauer tha gjithashtu se udhëheqja e Sekretarit të Përgjithshëm në këto kohë sfiduese për sigurinë globale ka qenë e pashembullt. "Ne ju konsiderojmë një gjeneral midis gjeneralëve dhe admiral midis admiralëve. Ju keni mbështetjen tonë të plotë", - tha Bauer dhe nënvizoi se Aleanca ka hyrë në një epokë të re të mbrojtjes kolektive. "Ne po mbrojmë kolektivisht jo vetëm sigurinë fizike të 1 miliard njerëzve dhe 31 kombeve tona, por edhe vlerat demokratike që të gjithë i kemi të shtrenjta. Fakti që ne jemi në gjendje të bashkëpunojmë me kaq shumë Forca të Armatosura të ndryshme, me kaq shumë aftësi dhe kultura të ndryshme është vërtet unike në botë", - tha ai.

Diskutimet u fokusuan fillimisht

në luftën agresionit të Rusisë kundër Ukrainës. "Rusia është në muajin e 15-të të asaj që ata mendonin se do të ishte një luftë 3-ditore. 'Goliath' po lëkundet. Dhe kjo për shkak se 'Davidi' ka treguar elasticitet të jashtëzakonshëm dhe shkëlqim taktik, të mbështetur nga 50 kombe në mbarë botën, tha ai, duke sjellë shembullin e fitores të së drejtës, mbi të padrejtën.

Në sesionin pasardhës takimi u fokusua në planifikimin aleat për parandalimin dhe mbrojtjen, "një proces i integritetit të pashembullt" të NATO-s dhe planifikimit ushtarak kombëtar. Admirali Bauer foli gjithashtu edhe mbi punën e jashtëzakonshme të bërë nga SHAPE dhe Komandat e Forcave të Përbashkëta Brunssum, Napoli dhe Norfolk. "Së bashku, ata kanë arritur një detyrë të rëndë, 18 muaj përpara afatit. Kjo është bërë e mundur edhe falë gjithë punës së bërë nga ekipet tuaja kombëtare, të cilat kanë kushtuar kohë, fuqi punëtore dhe burime të konsiderueshme për këtë përpjekje".

Takimi diskutoi zhvillimin e planeve rajonale, nën një fokus të rëndësishëm. "Këto janë plane gjeografikisht specifike që përshkruajnë se si do të mbrojmë vendet kyçe dhe relevante në Aleancën tonë kundër dy kërcënimeve të përshkruara në Konceptin Strategjik dhe Strategjinë Ushtarake të NATO-s, duke qenë Rusia dhe Grupet Terroriste. Planet Rajonale do të kërkojnë një Model të përmirësuar të Forcave të NATO-s për të prodhuar më shumë trupa me gatishmëri të lartë në të gjithë Aleancën tonë. Është e rëndësishme të theksohet se gatishmëria dhe efektiviteti janë shumë më tepër se numrat, si dhe nevoja për shpejtësi, fleksibilitet dhe një gamë të gjerë aftësish. Kjo është arsyeja pse ne gjithashtu forcojmë aftësitë tona komanduese dhe kontrolluese që korrespondojnë drejtpërdrejt me 'Kërkesat tona të Forcave të Reja', të cilat do të përcaktojnë numrin dhe llojet e pajisjeve dhe organizatave që ne kërkojmë, në të gjitha rajonet dhe të gjitha fushat. Për herë të parë që nga fundi i Luftës së Ftohtë, do të ketë objektiva konkrete, të bazuara në kërcënimet ndaj Kombeve. Këto objektiva do të kenë një ndikim të rëndësishëm në investimet dhe zhvillimet e ardhshme të Forcave të Armatosura aleate. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që ata të marrin mbështetje si nga niveli ushtarak ashtu dhe

nga ai politik ndërsa ne shkojmë drejt, përmes dhe përtej Samitit të Vilniusit".

Transformimi i Aleancës gjatë dekadës së fundit

Funksionet si kuadër osman për vite të tëra Skënderbeu i ushtroi në Shqipëri, duke u lidhur me mjedisin vendas dhe interesat e familjes së tij. Emri i Gjergj Kastriotit për herë të parë përmendet në Shqipëri bashkë me ata të vëllezërve të tij në dokumente të vitit 1426 për çështje pronësie. Në këtë kohë Skënderbeu kishte mbaruar shkollën e iç-ogllanëve dhe ishte në Shqipëri si spahi, më pas u bë subash i Krujës dhe qëndroi në këtë post zyrtarisht deri në fund të vitit 1438, kur në zeametn përkatës është shënuar se i ri jepej Zaganoz Beut. Qysh në fillim, kur u hartua regjistri kadastral osman i vitit 835 h. (1431-1432), zeameti i subashit të Krujës është regjistruar me emrin e Zaganoz Beut. Pas riemërimit zyrtar në fund të vitit 1438 në postin e subashit të Krujës, Zaganoz Beu duhet të jetë rikthyer me vonesë në Krujë, sepse Skënderbeu përmendet në Shqipëri edhe më 7 dhe 10 korrik të vitit 1439. Nuk dihet se cilët fshatra formonin timarin e tij në Shqipëri, kur ai ishte në postin e një spahi. Ndoshta kanë qenë disa fshatra të vilajetit të Dhimitër Jonimës, diku midis Lezhës e Rubikut, ku në mes të



viteve 30 Skënderbeu pati në zotërim një timar të madh, me të paktën nëntë fshatra.

Skënderbeu konsiderohej si bashkësundimtar me të drejta të plota me anëtarët e tjerë të familjes në veprimtarinë politike të Kastriotëve. Prandaj emri i tij është shënuar gjatë viteve 20 e 30 në aktet zyrtare që rregullonin marrëdhëniet e Kastriotëve me vendet e tjera, si p.sh. në vitin 1426 në një akt-blerje nga Kastriotët të një pingu pranë manastirit Hilandar në malin Athos dhe në një akt-dhurimi të dy fshatrave të Kastriotëve për manastirin e Hilandarit, si dhe në mars të vitit 1438 kur Stanisha dhe Gjergji kërkuan qytetarinë e Venedikut dhe më vonë (korrik 1439) edhe atë të Raguzës. Qytetaria veneciane e raguzane kërkohet që, në rast shkatërrimi e dëbimi nga zotërimet e veta prej osmanëve, familjarët e Gjonit të strehoheshin në këto vende.

Gjatë viteve të qëndrimit në Shqipëri si kuadër osman, Skënderbeu punoi aktivisht për mbrojtjen e interesave të familjes së tij. Kështu, sipas një dokumenti osman pa datë, kur Gjon Kastrioti ra në konflikt me osmanët dhe humbi krahinën e Ishmit (Mysjen), Skënderbeu u kërkoi autoriteteve osmane që ta merrte si zeamet këtë krahinë. Gjatë këtyre viteve ai kishte një timar të madh në trevën Lezhë-Rubik, që përshkohej nga udha e karvanëve që lidhte bregdetin me Prizrenin. Kjo rrugë ishte shumë e rëndësishme për veprimtarinë ekonomike e tregtare të shtetit të Kastriotëve.

parinë drejtuese shqiptare.

Sigurimi i privilegjeve dhe i qytetarisë së Venedikut e të Raguzës në fund të viteve 30, në një kohë kur Skënderbeu po përparonte në karrierën politike si kuadër i Perandorisë Osmane, tregojnë se ai e shikonte të ardhmen jo në kuadrin e karrierës së një funksionari osman. Përkundrazi, praninë e tij në radhët e kuadrove osmanë, ai e gjykonte si diçka të përkohshme. Në kushtet kur së bashku me të vëllanë, Stanishën, kishin marrë drejtimin e zotërimeve të Kastriotëve, largimin e tij nga posti i subashit të Krujës dhe emërimin si sanxhakbej larg Shqipërisë, Skënderbeu nuk mund ta shikonte si një "gradim", por si shprehje të mosbesimit të sulltanit ndaj tij.

Ndonëse kaloi një kohë të gjatë në shkollën e iç-ogllanëve e në vende të huaja si kuadër e komandant i shquar i ushtrisë osmane, Skënderbeu mbajti lidhje të ngushta me familjen e tij, me interesat e zotërimeve të tyre. Ai jetoi për vite të tëra në atdheun e vet, ku u brumos dhe u formua në mjedisin e luftës së shqiptarëve kundër pushtuesit të huaj osman dhe të disfatave të para që osmanët pësuan në Shqipëri gjatë kryengritjeve të viteve 30. Kthesa rrënjësore e Skënderbeut në nëntor të vitit 1443, duke ardhur në Shqipëri për të ngritur lart flamurin e luftës kundër pushtuesve osmanë, ishte rrjedhojë e përvojës jetësore shumë të pasur të tij dhe e luftës së shqiptarëve.

Më 1437-1438 Skënderbeu u bë qeveritar (subash) i vilajetit të Krujës dhe siguroi për këtë një feud të madh prej dhjetëra fshatrash. Ky gradim ndikonte shumë në forcimin e pozitave ekonomike e politike të zotërimeve të Kastriotëve që shtriheshin në lindje e në veri të vilajetit të Krujës.

Pas vdekjes së Reposhit (1431), që i qe kushtuar jetës fetare, dhe të Konstandinit, dy vëllezërit e tjerë drejtuan shtetin e Kastriotëve, sepse ati i tyre, Gjon Kastrioti, ishte i sëmurë dhe vdiq në maj të vitit 1437. Të dy vëllezërit i kushtuan vëmendje ruajtjes e forcimit të marrëdhënieve me Venedikun e Raguzën, prej të cilave arritën më 1438 e 1439 të siguronin të drejtat e privilegjet që kishte patur ati i tyre me ato dy vende. Ata vepruan bashkërisht deri kur vdiq Stanisha më 1446.

Pas vitit 1439 Skënderbeu nuk përmendet më në tokat shqiptare. Në këtë kohë në Ballkan po fillonin trazira të reja, si rrjedhojë e aksioneve ushtarake antiosmane të Janosh Huniadit. Prandaj sulltan Murati II e largoi Skënderbeun nga posti i subashit të Krujës, duke e emëruar sanxhakbej me sa duket larg tokave shqiptare, ndoshta në Nikopol të Bullgarisë.

Gjatë viteve të qëndrimit në Shqipëri si funksionar osman, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu del me emrin mysliman (Iskender) në dokumentet osmane, kurse në ato perëndimore ka përdorur vetëm emrin e krishterë Gjergj, gjë që shpreh lidhjet e tij me

8 Maji, Dita Europiane e Fitores ndaj makinerisë kriminale që prodhoi historia e njerëzimit



GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ

Me dhjetëra ngjarje kulmore, si dhe mijëra patriotë të mendjes, të pushkës dhe të penës janë skalitur me meritë në memorien e lavdisë së historisë sonë kombëtare. Por më 8 maj, Shqipëria i bashkohet me 31 vendet Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe disa vendeve partnere, si p.sh. Ukraina etj., në celebrimin e kësaj ngjarjeje.

Po çfarë simbolizon kjo datë dhe cilat janë vlerat dhe mesazhet e kësaj ngjarjeje të lavdishme?

78 vjet më parë, më 8 maj 1945, u nënshkrua në Berlin akti i kapitullimit të barbarisë naziste. Pavarësisht emërtimeve, si Dita e Fitores, apo Dita Europiane e Fitores, një gjë do të mbetet përjetësisht e përbashkët: “8 Maji është dita e çlirimit, është dita e kurorëzimit të qëndrësës, dita e lirisë dhe sakrificave të përbashkëta, është dita e çlirimit dhe e triumfit mbi një nga makineritë më kriminale që ka prodhuar historia e njerëzimit”.

Pikërisht më 8 maj 1945, Presidenti i SHBA-ve, Harry S. Truman, u dërgoi mesazh bashkë-liderëve të Koalicionit, Winston Churchill, Stalin, General De Gaulle, duke ndarë impresionet për këtë fitore të koalicionit të përbashkët. Në mënyrë të posaçme, më 8 maj Komandantit Suprem, gjeneralit brilant, më vonë President i SHBA-ve, Eisenhower, i kërkonte t’u përcillte emër për emër çdo luftëtar të çdo vendi koalicionit antifashist urimet më të përzemërta, mirënjohjen më të thellë, për sakrificat, kurajën dhe kontributin e paçmuar për gjunjëzimin e bishës naziste.

Po ashtu e gjej mbresëlënëse, dhe po perifrashoj, atë çka Presidenti Truman e mbyllte mesazhin e tij historik: “Ajo që na pret, ndërtimi i paqes, nuk është më pak e rëndësishme, nuk është më pak e vështirë, por Ne do ta ndërtojmë paqen duke kuptuar dhe punuar së bashku, ashtu siç e arritëm këtë fitore historike”!

Prandaj 8 Maji, përkujtohet fundi i një lufte çnjerëzore, që u shtri në mbarë planetin. Nderohet një kalvar vuajtjesh dhe sakrificash të pa përshkruara, një ferr që zgjati 5 vjet, që preku 80 % të popullsisë së globit dhe që mori jetën e 40-60 milionë fëmijëve, burrave dhe grave të pafajshëm nga mbarë vendet e botës.

Do ishte vërtet mëkat i madh të mbulohehin nga harresa disa dhjetëra miliona dëshmorë, mes tyre rreth 320 000 të masakruarit barbarisht në kampin famëkeq të Mathauzenit.



Pse edhe Shqipëria do duhet ta celebrojë këtë datë dhe këtë ngjarje heroike? Pa asnjë hezitim, e çmoj një “gjetje mjaft të goditur”, që në këtë ditë nderimi Shqipëria t’i bashkohet koalicionit fitimtarëve për t’u përlulur para kujtimit të qindra miliona burrave dhe grave që dhanë jetën dhe bënë sakrifica të mbinatyrshme, për ta shpëtuar njerëzimin nga gjenocidi nazist. Kjo datë është gjithashtu një memorie-nderimi dhe respekti të merituar për burrat dhe shtetarët e mëdhenj, si Churchill, Eisenhower, Zhukov, De Gaulle, etj., të cilët me vizion, përkushtim

dhe përgjegjshmëri drejtuan luftën dhe nënshkruan këtë fitore historike të koalicionit.

Pa dyshim, është detyrim shtetëror, por edhe fisnikëri njëherësh, të përulemi me mirënjohje ndaj të gjithë atyre që dhanë jetën, të kujtojmë dhe nderojmë emër për emër luftëtarët e kombit tonë, që u bashkuan kundër hordhisë fashiste pa dallim feje, krahine dhe bindjeje politike, që u ndeshen si të barabartë dhe e mposhtën një ushtri qindra herë më të madhe në numër, armatime, fuqi luftarake dhe organizim.

Po ashtu, është fakt gjerësisht i njohur,

dhe kështu një vlerë e veçantë, fakti që Shqipëria jonë e vogël iu bashkua këtij koalicioni të madh fitimtarësh, sfidash dhe vlerash të përbashkëta. Prandaj, ne duhet të ndihemi dyfish krenarë, pasi siç e ka përshkruar Henry Kissinger në librin e tij “Diplomacy”, Shqipëria ishte një ndër të vetmet vende që u vetë-çlirua pa prezencën e Ushtrisë së Kuqe, ose aleatëve perëndimorë.

Jo pa qëllim po sjell në vëmendje të publikut qëndrimin e një atdhetari të përkushtuar, dhe shtetari (ish-Kryeministër) mendjehapur si Mehdi Bej Frashëri, i cili më 7 prill, në Radio

Tirana i bëri thirrje popullit shqiptar që “të ngrihej me armë kundër pushtimit fashist” dhe mbresëlënëse mesazhet drejtuar Benito Musolinit: “Nga hiri i shpirtit të Gjergj Kastriot Skënderbeut, Ne ju bëjmë thirrje të pranoni pavarësinë e Shqipërisë z. Mussolini, përndryshe, armata juaj fashiste do të kalojë jo vetëm mbi kufomat e burrave dhe grave të këtij vendi”.

Por a nuk do të ishte shumë e padrejte të harrojmë, të mos përulemi me të njëjtin mirënjohje dhe respekt edhe para dhjetëra-mijëra luftëtarëve dhe familjeve të tyre që dhanë gjithçka për çlirimin e vendit, por u vranë, u burgosën dhe u persekutoan barbarisht nga regjimi komunist që u instalua mbas çlirimit nga nazifashistët.

Prandaj, 8 Maji, kjo ngjarje e madhe do duhet të na shërbejë, jo për të na ndarë sipas interesave politike të ditës, por si “ilaç për të mjekuar plagët e kohezionit dhe solidaritetit kombëtar”, mbi të gjitha, si urë e fortë bashkimi rreth flamurit, interesave kombëtare dhe si fanar për të na ndriçuar në udhëtimin drejt perspektivës europiane të Shqipërisë.

Për ta përmbyllur, po citoj mësimin e historisë se: “Nëse harrojmë, e keqja përsëritet edhe më mizorisht”. Neonazistët e rinj të Rusisë, po kërcënojnë jo vetëm integritetin e Ukrainës, po sfidojnë vlerat themelore, rendin global dhe stabilitetin demokratik të shoqërisë, si dhe po shkelin mbi sakrificat, rolin dhe vlerat e popullit Rus në fitoren e Luftës së II Botërore.

Prandaj 8 Maji përmban edhe një mesazh të fortë për çdo vend të NATO-s, rrjedhimisht edhe për vendin tonë, jo vetëm të mbështesim me deklarata Ukrainën, NATO-n, SHBA-të, në këtë betejë “për jetë a vdekje” me të keqen e përbashkët, por të marrin përgjegjësitë, të ndajnë barrën, për të përmirësuar rrënjësisht sistemin, institucionet dhe kapacitetet e sigurisë në përballjen me Neonazistët e rinj dhe sundimtarët e marrosur që po kërcënojnë më shumë se kurrë që nga Lufta e Dytë Botërore, rendin global vlerat euroatlantike, stabilitetin demokratik të shoqërisë dhe interesat jetike të qytetarëve, të secilit prej vendeve dhe në mbarë hapësirën tonë euroatlantike.

Prandaj 8 Maji meriton të celebretohet si një datë e lavdishme, por është edhe një ngjarje me mesazhe të përjetshme: “për lirinë, paqen, demokracinë, stabilitetin dhe vlerat themelore, duhet çdo ditë vigjilencë, duhet çdo ditë përkushtim, përgjegjshmëri dhe sakrifica!”

Pellazgët, gjeneza e civilizimit evropian

Pellazgët ishin një popull i lashtë, paraardhësit e të gjithë popujve indoevropianë. Për këtë popull antik që përhapi kulturën në gjithë Evropën dihet shumë pak, thuajse asgjë.

Gjuha e këtij populli quhej Pellazgjisht. Këtë e përmend në shkrimet e tij historiani antik (Diodor Siçiliani), i cili jetoi midis viteve 90 - 30 para erës sonë. Diodor Siçiliani shkruan se poetët parahomerikë janë shprehur me këtë gjuhë, pra Pellazgjishten, dhe me alfabetin që përdorej për ta shkruar atë.

Nga i njëjti burim mësojmë se kjo gjuhë është përdorur për të paktën 10 shekuj para erës së re. Më tej, Diodor Siçiliani raporton se ishin pellazgët ata që e sollën të parët alfabetin në gadishullin Italik, si dhe në pjesën tjetër të Evropës, duke bërë sigurisht përshtatjet dhe përmirësimet e nevojshme.

Këto të dhëna i konfirmon edhe shkrimtari romak Plini - i vjetri, i cili jetoi midis viteve 24 dhe 79 të erës sonë. Ndërsa Virgjili në veprën e tij Eneida (Eneida, VIII, V. 62-63) shkruan: "Thuhet se banorët e parë të Italisë sonë kanë qenë pellazgët".

Nga autorët e lashtësisë mësojmë se, para vendosjes së grekëve në gadishullin Italik, territori në të cilin ata u vendosën quhej Pellazgji. Burimet e ndryshme nga autorë antikë bëjnë gjithashtu të ditur se grekët mësuuan nga pellazgët jo vetëm artin e përpunimit të metaleve, të ndërtimit të mureve, por mësuuan nga ata edhe mënyrën e të shkruarit, duke përvetësuar edhe hyjnitë e tyre.

Homeri i përmend pellazgët si aleatët e Trojanëve.

"Zeusit Pellazg të Dodonës" Homeri i përmend pellazgët edhe si "Popujt e Kretës".

Mund të vazhdojmë pafund me citime për pellazgët nga autorë të antikitetit, si Pindari, Pausania, Ephorus of Cyme, Hesiodi etj., por pyetja kryesore që lind në këtë pikë është: *A ekzistojnë ende pellazgët?*

Nëse po, cilët janë ata?

Studiuesja dhe antropologja Nermin Vlora Falaski, në librin e saj "Trashëgimia gjuhësore dhe gjenetike", arriti të deshifronte mbishkrimet antike etruske dhe pellazge. Këto mbishkrime nuk ishin mundur të deshifrohenin me asnjë prej gjuhëve të përdorura në antikitet nga popujt që banojnë në zonat ku ato janë zbuluar, as me greqishten e lashtë, as me latinishten, etj.

Studiuesja Nermin Vlora Falaski arriti të deshifronte mbishkrimet antike pellazge dhe etruske, duke përdorur gjuhën e sotme shqipe, ose me saktë dialektin gegë të saj. Ky zbulim do të vërtetonte se shqiptarët, pasardhës të ilirëve, janë pasardhësit e sotëm të pellazgëve, njëri prej popujve më të lashtë që jetuan në Evropë.

Më poshtë do të sjellim disa prej mbishkrimeve antike të zbuluara në pjesë të ndryshme të Mesdheut, si në gadishullin Italik, në ishujt e detit Egje etj., të cilat mund të lexohen qartë, edhe sot, duke përdorur gjuhën shqipe.

PELAGO-ETRUSCO	ALBANESE	ITALIANO
𐌆𐌋𐌆𐌆 = OANIA	Ania	La nave
𐌆 = A	â	è
𐌆𐌋𐌆𐌆 = NAIE	naje	per noi
𐌆𐌋𐌆 = IRE	irë	coraggio, ferezza
𐌆𐌋𐌆 = LIRI	Liri	(c) liberta.

Mbishkrimi në foton më sipër shfaqet në një sarkofag të zbuluar në rajonin e Toskanës në Itali, zonë e njohur për vendbanimet e lashta etruske dhe pellazge. Pranë qytetit Cortona, në Val di Chiana, ndodhet një kështjellë e shndërruar në një muze arkeologjik. Në këtë muze gjendet edhe një mbishkrim veçanërisht i bukur dhe interesant, në një sarkofag me dekorime floreale.

Mbi sarkofag shkruhet: "O ANIJA Â NAIE IRË LIRI". Edhe pse gjuha e përdorur është disi arkaike, sepse mbishkrimi është bërë disa shekuj para lindjes së Krishtit, aty vihen re fare qartë fjalët shqip dhe kuptimi i gjithë mbishkrimit është i qartë edhe për lexuesin e thjeshtë që njeh gjuhën shqipe: "Anija është krenari, guxim dhe liri për ne".

Shkrimi në këtë rast fillon nga e djathta në të majtë. Duhet të kemi parasysh se në periudhën arkaike dhe më herët nuk kishte rregulla të përcaktuara të të shkruarit. Fjalët nuk ndaheshin nga njëra-tjetra me hapësirë dhe mund të shkruhej si nga e majta në të djathtë, ashtu edhe nga e djathta në të majtë.

Por ajo çka vëmë re në këtë mbishkrim është se fjalët janë qartësisht fjalë të përdorura edhe sot në gjuhën shqipe. Zëri foljor â ose âsht përdoret ende në të folurën e Shqipërisë së veriut dhe në Kosovë, pra në zonat shqipfolëse ku flitet dialekti gegë.

Nga kjo shprehje vëmë re edhe rëndësinë që kishte anija, pra mjeti i lundrimit, për këtë popull të lashtë. Pellazgët, të cilët quheshin edhe "Popull i detit", sepse ishin lundëtarë të zotë dhe të lirë, e quanin atdheun e tyre ILIRIA: LIRI (LIR = i lirë), që do të thoshte: "Vendi i njerëzve të lirë", një vend ky që shtrihej



nga Mesdheu deri në Danub.

Fjalët me rrënjën LIR mund të gjenden me të njëjtin kuptim në gjuhët: Pellazgo-ilire (liri), etruske (liri), shqipja sot (liri), italisht (libertà), frëngjisht (libertè), latinisht (libertas), anglisht (liberty), spanjisht (libertad), rumanisht (libertade), portugalisht (liberdade).

Në Itali, në rajonin e Lazio-s, ndodhet edhe lumi Liri. Pra ky emër është ruajtur gjatë shekujve në vendet e ndryshme të Mesdheut dhe Evropës, me shumë gjasa nëpërmjet zgjatimeve të fiseve të ndryshme ilire, sikurse ishin edhe Etruskët e Mesapët të vendosur në gadishullin Italik.

ILLIRICO	ALBANESE	ITALIANO
𐌆𐌋𐌆𐌆	Gajret	Sopporta
𐌆	ç	piangilo
𐌆𐌋𐌆𐌆	kraje (qaje)	sci
𐌆	is	angosciato
𐌆𐌋𐌆𐌆	ankh	Lascialo, affidalo
𐌆𐌋𐌆𐌆	lene	ith alla terra calda
𐌆𐌋𐌆𐌆	hiri	alla Grazia Celeste
𐌆	te	c
𐌆𐌋𐌆𐌆	te	al
𐌆𐌋𐌆𐌆	hajri	Supremo Bene

Në foton sipër paraqitet një mbishkrim ilir, i datuar midis shekujve III-II p.e.s., i cili aktualisht gjendet në muzeun arkeologjik të Durrësit.

Në të shkruhet: "GAI E KAIE IE ANK LENE ITH HRI E TE HAIRE", pra "Gajret e kjaie je ankh lene ith e hiri e te hajri". Është e rëndësishme të theksohet se gjuha e këtij mbishkrimi është aq e ngjashme me shqipen e sotme, sa që bën përshtypje kur mendon se ai daton më shumë se dy mijë vjet më parë.

Në përgjithësi, mbishkrimet më të vjetra janë formuluar nga e djathta në të majtë, dhe nganjëherë vazhdojnë nga e majta në të djathtë, pra në formë boustrofedike, shpesh pa ndërprerje ndërmjet një fjale dhe tjetrës. Megjithatë, ky mbishkrim i Durrësit është i gdhendur nga e majta në të djathtë, gjë që tregon origjinën e tij më të re, kur alfabeti latin, shumë më praktik, ishte përhapur gjerësisht, dhe tani shkruhej gjithmonë nga e majta në të djathtë.

Duke shkruar në kërkim të mbishkrimeve të reja, nga Egjeu në Atlantik dhe më tej në Egjipt e më gjerë, jo vetëm në përpjekje për të zbuluar përmbajtjen e tyre, por edhe për të verifikuar monogjenezën e gjuhëve që mbështetet nga studiues të shquar, në Muzeun Arkeologjik të Athinës është gjendur një gur varri shumë i lashtë, i cili përmban një mbishkrim bustrofedik të shkruar me alfabetin pellazg, i cili ka përmbajtje funerale.

Ky gur varri u zbulua në ishullin Lemnos. Në përgjithësi, çdo përpjekje e bërë për të kuptuar përmbajtjen e këtij shkrimi ka qenë e pasukseshme dhe jo bindëse. Është kjo arsyeja që deri më tani pak studiues janë angazhuar seriozisht për zgjidhjen e kësaj enigme. Ky gur varri i atribuohet shekullit të 6-të para Krishtit, por disa studiues e mbështesin tezën se është edhe më i vjetër.



Ky mbishkrim tërësisht boustrofedik, ku shkronjat "TH" dhe "H" përsëriten vazhdimisht, për të përfaqësuar psherëtimat dhe të qarat, siç do të bënim ne sot me pasthirrmat "AH" dhe "OH", përmban një vajtim funeral të ndjerë, padyshim për vdekjen e një afërmi, i cili kishte qenë edhe një hero i madh, siç dëshmohej edhe nga krenaria e përsëritur e të gjithë të afërmeve të tij në fjalët e mbishkrimit.

Mbishkrimi në këtë gur varri fillon, duke u lexuar nga e majta në të djathtë, me fjalët: "ZI A ZI MARAZ MATH". Këto fjalë mund të dallohen qartë në krye të mbishkrimit, në pjesën e sipërme të këtij guri.

Përmbajtja e gjithë mbishkrimit, e përkthyer me gjuhën shqipe (përshtatur për t'u bërë më e kuptueshme):

ETRUSCO	ALBANESE	ITALIANO
SI	Zi	Lutto
MALE	pa nalje	senza sosta.

Fjalën "ZI" e gjejmë, ndër të tjera, edhe në këtë mbishkrim të shkurtër, në një gur varri që ndodhet në Muzeun Arkeologjik të Feltre, në Itali, në të dallohet mbishkrimi "ZI PA NALE", pra "Zi pa ndalur" ose "Zi pa fund".

Duhet të kemi gjithmonë parasysh se pasuria gjuhësore e popujve është i vetmi arkiv dokumentar i padiskutueshëm, sidomos kur mungojnë prova të tjera, por mbi të gjitha është edhe dëshmia kryesore e krijimtarisë njerëzore.

Disa studiues mbështesin tezën e monogjenezës së gjuhëve, veçanërisht gjatë këtyre 2 shekujve të fundit, kur përparimi i komunikimit u ka dhënë njerëzve mundësinë të lëvizin lehtësisht dhe të kenë kontakte edhe me popullsi në zona shumë të largëta.

Përmendim këtu studiuesit italianë Alfredo Trombetti, Elia Lattes dhe Francesco Ribrezzo, të cilët janë mbështetës të kësaj teze, si dhe të origjinës ilire të popujve italik. Përveç autorëve të lartpërmendur, ka edhe studiues të tjerë gjermanë, austriakë, francezë dhe anglezë që pohojnë origjinën ilire të popujve italik.

Një meritë e veçantë i takon Prof. Zacharie Mayani, profesor në Universitetin e Sorbonës në Francë, i cili në vitet 1970 botoi 3 vëllime voluminoze, në të cilat argumenton se gjuha etruske përkthehet vetëm përmes gjuhës shqipe. Për të verifikuar vërtetësinë e zbulimit të tij, ai studioi gjuhën shqipe, fillimisht në Paris, e më pas shkoi në Shqipëri për ta përmirësuar. Tre vëllimet e botuara nga Mayani titullohen: "Les Etrusques Commencent a Parler", "Les Etrusques Parlent" dhe "La Fin Du Mystère Etrouque".

Sidoqoftë, i pari që hodhi dhe përhapi idenë e monogjenezës së gjuhëve ishte Sir William Jones (1746-1794), një orientalist i famshëm, i cili në fund të jetës së tij intensive dinte 28 gjuhë.

Në ditët tona, një mbështetës i rëndësishëm i kësaj teze është prof. Colin Renfrew, i Universitetit të Kembrixhit në SHBA, i cili në veprën e tij "Arkeologjia dhe Gjuhësia" botuar në vitin 1989, shkruan: "Arsyeja kryesore e botimit të kësaj vepre time është të theksoj se arkeologët e viteve të fundit nuk e kanë marrë parasysh siç duhet dëshminë e gjuhësisë për të rindërtuar të shkruarën".

Në botën tonë ka gjithmonë një horizont përtej të cilit nuk mund të shihet. Për sa i përket lashtësisë, horizonti ynë janë Pellazgët. Duke qenë shpikësit e parë të shkrimit fonetik, nuk mund të mohojmë se kultura e vërtetë fillon me pellazgët, sikurse kemi mësuar nga autorë të ndryshëm të lashtësisë.

Le të marrim disa dokumente epigrafike të gjetura nga Egjeu deri në Atlantik, në të cilat përmenden fjalët pellazgo-ilire: YJ, ARNO, REZE etj. Në një tempull të qytet-shtetit antik të Apolonisë gjendet një mbishkrim i shekullit të III para Krishtit që flet për yjet (YJ) dhe për një fëmijë (FIMI)...

Gratë luftëtare, dinjiteti dhe vlera e historisë ndër shekuj

Gratë kanë shërbyer në ushtri në shumë role të ndryshme, në juridiksione të ndryshme gjatë historisë.

Gratë në shumë vende nuk janë më të përjashtuara nga disa lloje të misioneve luftarake si pilotimi, mekanika dhe oficerët e këmbësorisë.

Prej vitit 1914, në ushtritë perëndimore, gratë kanë shërbyer në numër më të madh dhe role më të ndryshme se më parë. Në vitet 1970, shumica e ushtrive perëndimore filluan t'i lejonin gratë të shërbenin në detyrë aktive në të gjitha degët ushtarake.

Në vitin 2006, tetë vende (Kina, Eritrea, Izraeli, Libia, Malajzia, Koreja e Veriut, Peruja dhe Tajvani) rekrutuan gratë në shërbimin ushtarak.

Në vitin 2013, Norvegjia u bë vendi i parë i NATO-s që dërgoi gra, si dhe vendi i parë në botë që rekrutoi gratë me të njëjtat kushte formale si burrat. Në vitin 2017, Suedia fqinje ndoqi shembullin dhe në vitin 2018, Holanda iu bashkua këtij formacioni (megjithëse në Holandë nuk ka rekrutim aktiv në kohë paqeje). Që nga viti 2022, vetëm tre vende rekrutuan gra dhe burra me të njëjtat kushte formale: Norvegjia, Suedia dhe Holanda. Disa vende të tjera kanë ligje që lejojnë rekrutimin e grave në forcat e tyre të armatosura, megjithatë me disa dallime të tilla si përjashtimet nga shërbimi, kohëzgjatja e shërbimit dhe më shumë.

Gratë në Luftën e Parë Botërore

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Shtetet e Bashkuara ishin në përpjekje të përgjithshme luftarake. Çdo person duhej të kontribuonte në përpjekjet e luftës, megjithatë, kjo nuk do të thoshte domosdoshmërisht se të gjithë duhej të luftonin.

Vendi duhej të vazhdonte të financonte trupat e tij dhe të mbështeste luftën financiarisht ndërsa ushtarët po luftonin. Për këtë qëllim, Shtetet e Bashkuara u mbështetën te organizatat për mbështetje.

Gratë iu bashkuan organizatave të tilla si Komiteti për Informim Publik për të edukuar njerëzit për luftën. Ky komitet promovoi edhe nacionalizmin. Përveç punës në komisione që kanë të bëjnë me arsimin, gratë kanë punuar në të gjitha llojet e pozitave. Shumë gra u bënë anëtare të YWCA dhe shkuan jashtë shtetit për të ndihmuar ushtarët. Kjo ishte hera e parë në histori që gratë e të gjitha klasave po punonin së bashku për të ndihmuar përpjekjet e luftës.

Gratë e shtresës së lartë themeluan shumë organizata vullnetare të luftës, ndërsa gratë e klasës së mesme dhe të ulët punonin në këto organizata, duke punuar si infermiere ose duke plotësuar punët e burrave.

I vetmi komb që vendosi trupa luftarake femra në një numër të konsiderueshëm ishte Rusia.

Që nga fillimi, rekrutet femra ose iu bashkuan ushtrisë të maskuar ose pranoheshin në heshtje nga njësitë e tyre.

Më e shquara ishte në një kontingjent të kalorësisë së lehtë të vijës së parë në një regjiment kozak të komanduar nga një kolonele femër, Alexandra Kudasheva.

Zonja kolonele, Alexandra Kudasheva (1873-1921?) ishte komandantja e një regjimenti të kalorësisë së lehtë ruse nga 1915 - 1917 gjatë Luftës së Parë Botërore dhe gjithashtu gjatë Revolucionit Rus.

Ky regjiment kalorësie mund të



ketë qenë regjimenti i parë i integruar gjinor në historinë ruse, ajo u shqua gjithashtu për bëmat e saj të kalërimit të qëndrueshmërisë.

Të tjerë përfshinin Maria Bochkareva, e cila u dekorua tre herë dhe u gradua në gradën e nënofficerit të lartë.

Në Serbi, disa gra individuale luajtën role kryesore ushtarake.

Mjekja skoceze Elsie Ingles koordinoi një tërheqje prej rreth 8 000 trupash serbe përmes Rumanisë dhe Rosisë revolucionare, deri në Skandinavi dhe më në fund në anije transporti për në Angli.

Një grua tjetër, Milunka Saviq, u regjistrua në ushtrinë serbe në vend të vëllait të saj. Ajo luftoi gjatë gjithë luftës, duke u bërë ndoshta gruaja më e dekoruar në historinë ushtarake.

Një ligj i vitit 1948 i bëri gratë pjesë të përhershme të shërbimeve ushtarake. Në vitin 1976, grupi i parë i grave u pranuan në një akademi ushtarake të SHBA-së.

Përafërsisht 16% e klasës së 'West Point 2013' përbëhej nga gra.

Në Luftën Civile Finlandeze të vitit 1918, më shumë se 2000 gra luftuan në Gardën e Kuqe të Grave.

Gjatë Luftës Civile Spanjolle, mijëra gra luftuan në njësitë luftarake dhe praparoje me gjini të përzier, ose si pjesë e milicive.

Disa vende lejojnë ushtarët femra të shërbejnë në pozicione të caktuara të armëve luftarake.

Të tjerët i përjashtojnë ato për arsye të ndryshme, duke përfshirë kërkesat fizike dhe politikat e privatësisë.

Vendet jo-rekrutimi, veçanërisht Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe Kanadaja janë vendet ku u arrit niveli më i lartë i pranisë ushtarake të femrave.

Kanadaja është vlerësuar progresive në zbatimin e hershëm të praktikave të barazisë gjinore.

Një rritje e thirrjes për mundësi të barabarta, e shoqëruar me rënien e burrave të aftë për punë, të gatshëm për të hyrë në shërbimin ushtarak, nxiti vendet të reformojnë politikat drejt përfshirjes së grave.

Me hapjen e shërbimit të nëndetëseve në vitin 2000, gratë tani kishin lirinë për t'u regjistruar në çdo

lloj shërbimi ushtarak.

Gra me gjurmë të arta në histori Mbretëresha e Massagetit, u bë e famshme për fitoren dhe vrasjen e perandorit pers Kiri i Madh (530 p.e.s.), kur ai sulmoi vendin e saj për



ta pushtuar. Shpirti i saj i copëtuar u bë legjendar, për t'u hakmarrë për vdekjen e të birit, i cili u vra nga Kiri i Madh në dyluftim, pasi e vrau perandorin pers, ia zhyti kokën në një lëkurë dhie të mbushur me gjak dhe më pas ia këputi. Sipas disa gojëdhënave e mbajti kafkën e perandorit gjithë jetën e saj, duke e përdorur si kupë për të pirë verë.

Mbretëresha e Palmirës, Ksenia-Ksenobia (Shek. III e.r.) (qyteti antik që u shkatërrua nga ISIS) ishte një mbretëreshë krenare anti-romake. Mbretëria e saj në momentin e zgjerimit më të madh shkonte nga Siria deri në kufij me Egjiptin. Mbretëresha synonte të zgjeronte territoret e saj në të gjithë Azinë e Vogël. Në vitin 270 kërkoi të arrinte një marrëveshje me perandorin romak Aureliano për të konsoliduar kufijtë e territoreve nën mbretërinë e saj. Por si përgjigje Aureliano bëri

një kundërofensivë, duke e mundur në Emesa në vitin 272 e.r.. Pas rrethimit të Palmirës ndërkohë që tentonte të largohej për në Persi u zu rob, por Aureliano i fali jetën dhe e dërgoi në Romë, duke i bërë dhe shëtitjen si trofe lufte.

Çupëlina e ORLÉANS - Zhan D'Ark (1412-31) jetoi përgjatë periudhës së luftës njëqindvjeçare (1337-1453), ku në konflikt ishin dy kombe që po lindnin Franca dhe Anglia. Me origjinë jo fisnike, në moshën 17-vjeçare, kishte bindjen në vetvete se ishte përzgjedhur nga Zoti për të shpëtuar Francën dhe pasi përshkoi 2000 km dhe mbërriti në oborrin e Karlit të Shtatë dhe kërkoi të kalëronte në krye të ushtrisë që shkonte në ndihmë të Orléans, e rrethuar nga ushtria e Enrikut VI. Pasi mori konsensusin e mbretit Çupëlina dhe ushtria e saj ia dolën të çlirojnë Orléans. Por karriera e saj u ndërpre shumë shpejt, pasi e kapën një vit më pas në një kurth, iu dorëzua Mbretit të Lukesburgut, i cili ia dhuroi si trofe lufte anglezëve. Në vitin 1431, në moshën 19-vjeçare, u akuzua për heretizëm dhe u dogj e gjallë. Zhan D'Ark është shenjtëruar dhe është patrone e Francës.

e armëve për të mbrojtur shtëpinë e tyre, familjen dhe nderin në kohë lufte. Nakano Takeko u vendos në krye të një trupe speciale të përbërë nga gra luftëtare, një lloj ushtrie femërore, e cila lufton me një shpatë japoneze naginata. Vdiq në fushën e betejës së Aizu (1868) në kulmin e Luftës civile japoneze.

Asia Ramazan (1996-2014), një luftëtare kurdë, e cila kërkoi të ndalonte avancimin e ISIS në territoret e Kurdistanit sirian. Në vitin 2014, vetëm 18 vjeç u bë vullnetare e radhëve të Ypj- milicisë femërore kurde, pjesë e milicisë së Kurdistanit sirian. U bë e famshme në mediat perëndimore si simbol i heroinës rezistuese, dhe vdiq në vitin 2016 në një betejë në Minbic, Siria e Veriut.



Më 11 maj 1771, në një burg të Stambollit lindi Dhaskarina Pinoçi (Bubulina), luftëtarja më e njohur arvanitase. Bubulina ishte e bija e Stavro dhe Skevo Pinoçit. I ati Stavro, ishte një kapedan deti shqiptar (arvanitas) i burgosur në Stamboll. Pas vdekjes së tij e ëma dhe Bubulina kthehen në Hidra.

Emri Bubulina i mbeti pas vdekjes së burrit të dytë, Dhimitër Bubulit. Fama e saj si detare dhe luftëtare, mbushi Europën e Perandorinë Osmane. Pikturat e saj u publikuan në qendrat kryesore të Evropës, si Parisi, Londra, etj. Dhaskarina u vra në Speca nga dora e një shqiptari (arvanitasi) tjetër, Kristo Kuçi, vajza e të cilit u rrëmbye nga i biri i Bubulinës.



Mbretëresha e Forli-së - Caterina Sforza (1463-1509), vajza e Galeazzo Maria Sforza dhe nëna e Giovanni dalle Bande Nere, qeverisi mbi provincën e Imola dhe Forli.

E mbiquajtur 'Tigreshë' për kurajën dhe vendosmërinë e saj, u mor vetë në mënyrë direkte për mbrojtjen e shtetit të saj, planifikonte manovrat ushtarake, për nevojat e ushtrisë, armët dhe kuajt si dhe stërvitjen ushtarake. Por kjo nuk mjaftoi që të arrinte të ruante territoret e saj nga pushtimet e famëkeqit Cesare Borgia, i mbiquajtur il Valentino. U burgos në Romë, pasi rifitoi lirinë, jetoi vitet e fundit të jetës së saj në Firence.

Nakano Takeko (1847-68) ishte onna-bugeisha, pra një grua luftëtare e cila i përkiste aristokracisë japoneze. Këto gra mund të merrnin pjesë në betejat, së bashku me meshkujt samurai dhe ishin të stërvitura në përdorimin



<https://www.mod.gov.al/rekrutim>

M

e propozim të Ministrisë së Mbrojtjes, qeveria shqiptare ka vendosur rritjen në masën 7% të pagës bazë, sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armato-

sura. Kjo shënon rritjen më të madhe të pagave të ushtarakëve, të cilët një vit më parë morën një tjetër shtesë page për të gjitha kategoritë në masën 30%, të cilën e përfitojnë 6654 ushtarakë.

Aktualisht Ministria e Mbrojtjes ka nisur fushatën e rekrutimeve për 400 pozicione të lira pranë FA-së, si ushtarë apo detar aktiv. Kjo thirrje është e hapur për të gjithë të rinjtë e moshave 18-27 vjeç me arsim 9-vjeçar, të mesëm apo të lartë. Ndër përfitimet që marrin të gjithë ata që zgjedhin të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura janë:

- Puna e garantuar në FARSH dhe mundësi për karrierë të suksesshme, të ardhura mujore dinjitoze, si asnjëherë më parë për FA-të;
- Shërbim shëndetësor për vete dhe familjarët dhe mundësi kurimi të specializuar brenda dhe jashtë vendit;
- Sigurim shoqëror dhe përfitime suplementare pas

përfundimit të karrierës;

- Mundësi arsimimi dhe kualifikimi ushtarak brenda dhe jashtë vendit pa pagesë;
- Përparim në gradë dhe karrierë;
- Përgatitje fizike sipas standardeve të NATO-s;
- Angazhim në misione paqeruajtëse në kuadrin e NATO-s, OKB-së dhe BE-së, me përfitime financiare të konsiderueshme;

Po ashtu, për çdo të ri që bëhet pjesë e FA-së ofrohen trajnime dhe stërvitje jashtë vendit së bashku me kolegë të tjerë të NATO-s dhe SHBA-së, lehtësira për qira banese, transferim bashkëshorti/e, trajtim me ushqim, pagesë transporti si dhe kredi me norma të lehtësuara për banesën e parë të familjeve ushtarake. Me rritjen e fundit të pagave, një oficer (grada e parë për ushtarakët oficerë të titulluar nëntoger), pas kryerjes së studimeve në Akademinë e Forcave të Armatosura, merr një pagë mbi 77 mijë lekë, pa përfshirë shtesat mbi pagë për kompensim ushqimor, shtesat për natyra të veçanta apo trajtimin me uniformë ushtarake, sportive, etj.